



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 104

Tiranë – E mërkurë, 12 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 101, datë 5.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10995
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 13, datë 30.6.2023	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit..... 10995
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 367/11, datë 10.7.2023	Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi i peizazhit urban të sheshit të ‘Selamllikut’, i lagjes ‘Mangalem’”..... 11010
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 373/6, datë 10.7.2023	Për disa shtesa në VKM-në nr. 31, datë 17.1.2018, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Rehabilitimi i lumit Gjanicë, Fier’”..... 11012
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 420/7, datë 11.7.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Qendra shëndetësore ‘Drobonik’, Bashkia Berat”. 11012

**DEKRET****Nr. 101, datë 5.7.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/220, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anisa Hasani
2. Albana Refit Rrokaj (Lacaj)
3. Nexhisab Dilaver Koçiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 13, datë 30.6.2023****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURAVE TË
NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE
DHE TË DIPLOMAVE TË NXËNËSVE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
ARDHUR NGA JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 4, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomës së arsimit të mesëm të lartë të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin parauniversitar, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

2. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesave të klasave të nxënësve të arsimit parauniversitar të fituara jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin parauniversitar, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, janë zyrtat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP).

3. Njohja dhe njësimi i diplomës së arsimit të mesëm të lartë, bazuar në procedurën zyrtare të njëvlershmerisë, ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimin e lartë, ose punësimin në Republikën e Shqipërisë.

4. Njohja dhe njësimi i dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesave të klasave të nxënësve të arsimit parauniversitar të fituara jashtë vendit, bazuar në procedurën zyrtare të njëvlershmerisë, ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

5. Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Kualifikimi” është një rezultat formal i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfituar prej një organi kompetent/institucioni arsimor, të akredituar, që përcakton se individ i ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë.



b) “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxëniet të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

c) “Korniza Evropiane e Kualifikimeve”, në vijim “KEK”, sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, është një kornizë që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënë gjatë të gjithë jetës.

ç) “Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC)” është një rrjet me qendra kombëtare i ngritur për të mbështetur institucionet dhe qytetarët me njohjen e kualifikimeve parauniversitare. QSHA-ja shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave/dëftesave të arsimit parauniversitar për Republikën e Shqipërisë.

d) “Refugjat” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.

dh) “Person i zhvendosur” është çdo person, i cili është detyruar të largohet nga shteti, shtetësinë e të cilit ka, ose nga vendi ku ka rezidencën e zakonshme/vendin e banimit të zakonshëm për të shmangur konfliktet e armatosura, dhunën, shkeljen e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë natyrore, ose të shkaktuara nga njeriu, i cili nuk ka kaluar kufijtë e një shteti ndërkombëtarisht të njohur.

e) “Persona të ngjashëm me refugjatët” është çdo person, i cili ndodhet *de facto* në një situatë të ngjashme me atë të refugjatit, personave të zhvendosur, pavarësisht statusit të tyre ligjor.

f) “Kualifikim i dokumentuar në mënyrë jo të përshtatshme” është kualifikimi i fituar nga

mbajtësi i tij, i cili nuk mund të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve të nevojshme.

6. QSHA-ja dhe ZVAP-ja nuk shqyrtojnë aplikimet, për rastet si më poshtë:

a) diploma/dëftesa të arsimit parauniversitar, të fituara në Republikën e Shqipërisë;

b) diploma/dëftesa klase të lëshuara nga shkolla, të hapura/licencuara, si shkolla që e ofrojnë mësimin *online*, sipas përcaktimit të diplomës/dëftesës/dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucioni që ka lëshuar diplomën/dëftesën e arsimit parauniversitar;

c) certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter.

Për rastet e përmendura në këtë pikë të udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mosshqyrtimin e aplikimit.

7. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/dëftesa për njëvlershmëri, janë:

a) të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura dhe/ose të akredituara të arsimit parauniversitar në vendin e origjinës;

b) diploma/dëftesa të jetë e njohur në datën e lëshimit të saj;

c) diploma/dëftesa të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;

ç) diploma/dëftesa të jetë autentike.

8. Informacioni paraprak mbi institucionet e arsimit parauniversitar që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me standardet përkatëse të vendit të origjinës, mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Rrjetit Evropian të Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC). Në lidhje me dhënien e informacionit për të interesuarit për sistemin dhe institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe kualifikimet e lëshuara prej tyre në Republikën e Shqipërisë institucioni përgjegjës është QSHA-ja.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN E DËFTESAVE TË ARSIMIT BAZË, DËFTESAVE TË KLASAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË MESEM TË LARTË

1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesave të klasave,



si dhe diplomës së arsimit të mesëm të lartë, që i përkasin nivelit 1 deri në 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kryhet *online* nëpërmjet portalit *e-Albania*.

2. Aplikimi kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) Formulari i aplikimit për dëftesat e përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesa klase të arsimit parauniversitar plotësohet *online* në portalin *e-Albania*.

b) Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. dëftesën e përfundimit të arsimit bazë, dëftesa klase, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. dokumentin e vijueshmërisë së klasës nëse nxënësi nuk e ka përfunduar klasën, të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iii. fotokopjen e dokumentit të identifikimit.

c) Formulari i aplikimit për diplomën e arsimit të mesëm të lartë plotësohet *online* në portalin *e-Albania*.

d) Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën e arsimit të mesëm të lartë ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. dëftesat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, të pajisura me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuara me origjinalin (noterizuara), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iii. dokumentin që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iv. fotokopjen e dokumentit të identifikimit.

3. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit *online*, si dhe të dërgohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit *online* edhe në rrugë postare, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) pas kryerjes së aplikimit *online*, për njohjen dhe njësimin e dëftesave të arsimit bazë dhe dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar, në rrugë postare dërgohet në ZVAP dokumentacioni i specifikuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij kreu;

b) pas kryerjes së aplikimit *online*, për njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, në rrugë postare dërgohet në QSHA dokumentacioni i specifikuar në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij kreu.

KREU III

PROCEDURAT E NJOHJES DHE TË NJËSIMIT TË DËFTESËS SË PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT BAZË DHE TË DËFTESAVE TË KLASAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. Procedura e njohjes dhe njësimit të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe të dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar, pas aplikimit *online* vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Dëftesave në ZVAP. Kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, kjo procedurë përfundon brenda 45 ditëve.

1.1 Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim.

Informimi dhe kërkesa për plotësim dokumentacioni bëhet me postë elektronike. Procedura e njohjes dhe njësimit fillon menjëherë pasi ZVAP-së i është shfaqur aplikimi në sistemin *online* në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.



Brenda 5 (pesë) ditëve nga fillimi i procedurës së njohjes dhe njësimit, ZVAP-ja kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar dëftesën e përfundimit të arsimit bazë ose dëftesën e klasës.

1.2 Në çdo rast, procedura e njohjes dhe e njësimit nuk mund të përfundojë nëse aplikanti nuk paraqet në ZVAP në formatin shkresor me postë dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim.

1.3 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, Komisioni i Njohjes së Dëftesave i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me anë të postës elektronike, të cilat duhet të depozitohen brenda 30 ditëve në ZVAP. Në të kundërt, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në ZVAP.

1.4 Komisioni i Njohjes së Dëftesave llogarit afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe të dëftesës/dëftesave të klasave, duke iu referuar datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

2. ZVAP-ja, në zbatim të procedurës së verifikimit:

a) Kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe të dëftesës/dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar.

b) I kërkon institucionit arsimor (IA) përkatës, përmes postës elektronike, konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe, në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 (një) viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IA-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në ZVAP. Aplikanti njoftohet për vendimin e komisionit mbi arkivimin e dokumentacionit.

Gjithashtu, konfirmimi kërkohet edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit.

c) Depoziton në dosjen e aplikantit materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera shkresore ose të printuara. Për verifikimet e

kryera *online*, dokumentacioni i printuar nënshkruhet nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

3. Komisioni i Njohjes së Dëftesave ngrihet me urdhër të titullarit të ZVAP-së, si dhe drejtohet nga kryetari dhe përbëhet nga tre anëtarë. Komisioni shqyrton, njeh dhe njëson dëftesën e përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesa klase të arsimit parauniversitar.

4. Njëvlershmëria e rezultateve të arritura në shtetin përkatës të kryhet sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4.1 Njëvlershmëria e notave në sistemin shqiptar bëhet me nota të plota, duke krahasuar sistemin e vlerësimit në shtetin që ka lëshuar dokumentin shkollor me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në tabelë, njëvlershmëria bëhet me sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet dhe ENIC/NARIC.

4.3 Në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se sistemi i vlerësimit është i ndryshëm nga ai i parashikuar në shtojcën 3, njëvlershmëria bëhet sipas sistemit të vlerësimit të kohës kur është lëshuar dokumenti, duke shkarkuar sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet dhe ENIC/NARIC.

5. Komisioni i Njohjes së Dëftesave, pas marrjes së vendimit të njohjes dhe njësimit, lëshon vërtetimin përkatës për çdo aplikant, i cili nënshkruhet nga titullari i ZVAP-së dhe nga kryetari i komisionit, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur Komisioni nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë ose të dëftesës së klasës të arsimit parauniversitar, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit për arsyet dhe mangësitë e aplikimit.

6. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe i dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar, lëshohet në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Dëftesës dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

7. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:



- a) emrin dhe mbiemrin e aplikantit;
- b) institucionin e huaj arsimor të arsimit parauniversitar që ka lëshuar dëftesën e arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit parauniversitar;
- c) shtetin përkatës;
- d) njëvlershmërinë e rezultateve të arritura në shtetin përkatës;
- e) datën e lëshimit të dëftesës së arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit parauniversitar;
- f) njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

8. ZVAP-ja është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrit zyrtar të njohjes dhe njësimit të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit parauniversitar. Regjistrat mbahen në formatin *hard copy* dhe në atë elektronik. ZVAP-ja publikon listën emërore të personave të cilëve u janë njohur dhe njësuar dëftesa e përfundimit të arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit parauniversitar në faqen e saj zyrtare të internetit.

9. Pasi ZVAP-ja ka njohur dhe njësuar dëftesën e përfundimit të arsimit bazë/dëftesa klase të arsimit bazë, njofton zyrtarisht drejtorin e shkollës për klasën ku nxënësi do të regjistrohet, si dhe i dërgon një kopje të vërtetimit të njohjes dhe njësimit, i cili përmban vlerësimet e njëvlerësuar.

10. ZVAP-ja, në mungesë të dokumentit të vijueshmërisë së klasës 1–9, kur nxënësi nuk e ka përfunduar atë, njofton drejtorin e shkollës që nxënësi të vlerësohet nga një komision i ngritur prej tij, për klasën e pretenduar nga deklarimi me shkrim i prindit. Nxënësi regjistrohet në klasën që miraton ky komision. Drejtoria e shkollës, pas regjistrimit të nxënësit, organizon hartimin dhe zbatimin nga mësuesit të programeve individuale që synojnë plotësimin e mangësive të nxënësit.

11. Pasi ZVAP-ja ka njohur dhe njësuar dëftesën e klasës së arsimit të mesëm të lartë, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar dhe planit mësimor të shkollës, ku nxënësi do të regjistrohet, dërgon zyrtarisht në shkollë vërtetimin e njëvlershmërisë për lëndët që nxënësi ka kryer sipas planit mësimor të shkollës pritëse, si dhe lëndët të cilat duhet të japë provim.

a) Kur nxënësi ka plotësuar më pak se gjysmën e lëndëve të planit mësimor të klasës ku kërkon të regjistrohet, atëherë përsërit klasën.

b) Kur nxënësi ka plotësuar më shumë se gjysmën e lëndëve të planit mësimor të klasës ku kërkon të regjistrohet, atëherë regjistrohet në klasën që kërkon dhe jep provim çdo lëndë që nuk ka kryer dhe i përket planit mësimor. Provimet jepen brenda 3 ditëve, pasi ka marrë miratimin për regjistrim.

c) Drejtori i shkollës cakton datat e provimeve lëndore në periudhën e përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike.

KREU IV

PROCEDURAT E NJOHJES DHE TË NJËSIMIT TË DIPLOMËS SË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

1. Procedura e njohjes dhe njësimit e diplomës së shkollës së mesme, që i përket nivelit 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, pas aplikimit *online*, vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

1.1 Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar (SNJD) në QSHA shërben si sekretariat teknik i Komisionit të Njohjes së Diplomave.

1.2 Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim.

1.3 Informimi dhe kërkesa për plotësim dokumentacioni bëhet me postë elektronike. Procedura e njohjes dhe njësimit fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në sistemin *online* në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

1.4 Brenda 5 (pesë) ditëve nga fillimi i procedurës së njohjes dhe njësimit, SNJD-ja kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën.

1.5 Në çdo rast, procedura e njohjes dhe e njësimit nuk mund të përfundojë, nëse aplikanti nuk paraqet me postë në QSHA në formatin shkresor dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim.

1.6 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SNJD-ja i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit me anë të



postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me anë të postës elektronike, të cilat duhet të depozitohen brenda 30 ditëve në QSHA. Në të kundërt, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA.

1.7 SNJD-ja llogarit afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njohjen dhe njësimin e diplomës, duke iu referuar datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

2. QSHA-ja, në zbatim të procedurës së verifikimit:

a) Kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës;

b) I kërkon IA-së përkatëse, përmes postës elektronike, konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë, dhe në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Gjithashtu, konfirmimi kërkohet edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit.

c) Në rast se pas 1 (një) viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IA-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave mbi arkivimin e dokumentacionit.

d) QSHA-ja, sipas rastit, kërkon informacion pranë qendrave të Rrjetit Evropian të Informimit dhe Njohjes së Diplomave (ENIC–NARIC) dhe institucioneve përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucioneve të arsimit parauniversitar, vlefshmërinë e diplomave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës.

e) Materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online*, dokumentacioni i printuar nënshkruhet nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

3. Komisioni i Njohjes së Diplomave ngrihet me urdhër të titullarit të QSHA-së, si dhe drejtohet nga kryetari dhe përbëhet nga tre anëtarë. Komisioni i Njohjes së Diplomave shqyrton, njeh dhe njëson diplomën e arsimit të mesëm të lartë.

4. Njëvlershmëria e rezultateve të arritura në shtetin përkatës të kryhet sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4.1 Njëvlershmëria e notave në sistemin shqiptar bëhet me nota të plota, duke krahasuar sistemin e vlerësimit në shtetin që ka lëshuar dokumentin shkollor me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në tabelë, njëvlershmëria bëhet me sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet dhe ENIC/NARIC.

4.3 Në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se sistemi i vlerësimit është i ndryshëm nga ai i parashikuar në shtojcën nr. 3, njëvlershmëria bëhet sipas sistemit të vlerësimit të kohës kur është lëshuar dokumenti, duke shkarkuar sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet dhe ENIC/NARIC.

5. Njëvlershmëria e rezultateve të provimeve të maturës shtetërore të arritura në shtetin përkatës kryhet duke krahasuar sistemin e vlerësimit të maturës në shtetin që ka lëshuar dokumentin e maturës me sistemin e vlerësimit të maturës në Republikën e Shqipërisë.

5.1 Njëvlershmëria e notave të maturës në sistemin shqiptar bëhet me nota të shkallëzuara, duke krahasuar sistemin e vlerësimit të maturës në shtetin që ka lëshuar dokumentin e maturës, me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.

5.2 Për shtetet, sipas legjislacionit të të cilave nxënësit mund të regjistrohen në institucionet e arsimit të lartë edhe duke qenë mbetës në provimet e maturës, si dhe janë pajisur me dokumentin zyrtar të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, njëvlershmëria e notave të maturës do të kryhet sipas mesatares të shkallëzuar të notave të lëndëve përkatëse gjatë viteve të shkollës së mesme.

5.3 Për shtetet, sipas legjislacionit të të cilave nuk ka sistem mature dhe nxënësit janë pajisur me dokumentin zyrtar të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, njëvlershmëria e notave të maturës do të kryhet sipas mesatares të shkallëzuar të notave të lëndëve përkatëse gjatë viteve të shkollës së mesme. Ata nuk kanë detyrim që të japin provim mature në Republikën e Shqipërisë.

6. Komisioni i Njohjes së Diplomave njëvlerëson lëndën, e cila përcakton njohuritë



gjuhësore dhe letrare të shtetit nga vjen nxënësi, me lëndën/lëndët “Gjuhë shqipe dhe letërsi”.

7. Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të diplomës së shkollës së mesme, ose mund të vendosë ta kthejë për plotësime të tjera të nevojshme të dokumentacionit të sekretaria teknike (SNJD), sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SNJD) zbardh raportin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave, i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur Komisioni nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e diplomës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit për arsyet dhe mangësitë e aplikimit.

8. Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA, për njohjen dhe njësimin e diplomës, interpreton dhe merr vendim të argumentuar mbi njohjen ose jo, të mbështetur në legjislacionin shqiptar për arsimin parauniversitar, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si edhe në praktikat më të mira të njohura të vendeve perëndimore.

9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit për diplomën e shkollës së mesme, që i përket nivelit 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, lëshohet i nënshkruar nga titullari i QSHA-së dhe nga kryetari i Komisionit të Njohjes së Diplomave në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

10. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës së shkollës së mesme përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

- a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
- b) institucionin e huaj të arsimit parauniversitar që ka lëshuar diplomën;
- c) shtetin përkatës;
- d) njëvlershmërinë e rezultateve të arritura në shtetin përkatës;
- e) datën e lëshimit të diplomës;
- f) llojin e arsimit të mesëm të lartë;
- g) tabelën e njëvlershmërisë të notave dhe notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- h) notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë;
- i) notën mesatare të provimeve të maturës;

j) notën mesatare të përgjithshme të njëvlersuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për notën mesatare;

k) njohjen dhe njësimin e diplomës të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

11. QSHA-ja është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrat zyrtar të njohjes dhe njësimit të diplomave. Regjistrat mbahen në formatin *hard copy* dhe në atë elektronik.

12. QSHA-ja publikon listën emërore të personave të cilëve u janë njohur dhe njësuar diplomat në faqen e saj zyrtare të internetit.

KREU V

NJOHJA E DËFTESËS SË ARSIMIT BAZË, DËFTESAVE TË KLASAVE DHE DIPLOMËS SË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË TË PERSONAVE QË KANË STATUSIN E REFUGJATIT, PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE PERSONAVE TË NGJASHËM ME REFUGJATËT

1. Për personat që kanë statusin e refugjatit, personit të zhvendosur dhe/ose personit të ngjashëm me refugjatin, nuk zbatohen procedurat e parashikuara në kreun II të këtij udhëzimi.

2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesa klase të arsimit parauniversitar, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në ZVAP, sipas shtojcës nr. 1,

b) aplikanti dorëzon në ZVAP dokumentacionin e mëposhtëm:

i. dëftesën e arsimit bazë, dëftesa klase të lëshuara nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. dokumentin e vijueshmërisë së klasës nëse nxënësi nuk e ka përfunduar klasën, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;



iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.

3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë që i përket nivelit 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 2,

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. dëftesat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, të njësuar me origjinalet (të noterizuara), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iii. dokumentin që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, të njësuar me origjinalin (të noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iv. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;

v. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.

4. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit, me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për t'u punësuar.

5. Për njohjen dhe/ose njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar, të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë dhe/ose periudhave të studimit nga mbajtësit/titullarët e statusit të refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatët, organet kompetente përcaktojnë procedurat e përshtatshme të vlerësimit, vlefshmërisë dhe kriterëve të tjera, që lejojnë njohjen e këtyre kualifikimeve dhe/ose periudhave të studimit, edhe në mungesë të verifikimit të vlefshmërisë së tyre, apo mungesës, apo paraqitjes së dokumentacionit të pjesshëm ligjor, në ato raste kur personat e interesuar provojnë pamundësinë për të verifikuar vlefshmërinë e këtyre diplomave/certifikatave, ose nuk mund të paraqesin dokumente që ta bëjnë këtë gjë.

6. Për njohjen e periudhave të studimit të përcaktuara në këtë krye, organet kompetente u referohen dispozitave përkatëse të këtij udhëzimi, akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare të njohura nga rrjeti ENIC-NARIC.

7. Kualifikimet e paraqitura sipas përcaktimeve të këtij kreu duhet të vlerësohen nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga burime të besueshme publike, rrjeti ENIC-NARIC, nga personi që aplikon për njohjen e kualifikimit dhe/ose periudhave të studimit dhe, sipas rastit, duhet të plotësohet me intervista me aplikantin, provimet dhe çdo metodë tjetër të përshtatshme vlerësimi.

Organet kompetente për njohjen dhe njësimin e dëftesës të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar dhe/ose periudhave të studimit, duhet të përdorin çdo mjet të disponueshëm dhe çdo informacion të besueshëm për të verifikuar institucionet ku janë fituar kualifikimet, apo janë kryer periudhat e studimit dhe, gjithashtu, të përdorin, për aq sa është e mundur, çdo informacion apo praktikë të vlerësimeve të mëparshme për kualifikime të ngjashme për sa u përket vlefshmërisë, cilësisë, nivelit dhe rezultateve të të nxënit.

8. Organet kompetente në rastet kur refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, për arsye të përligjura nuk mund të provojnë dhe të dokumentojnë kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit që ata pretendojnë, hartojnë një raport, i cili duhet të përmbajë një



informacion të detajuar për kualifikimin e fituar, ose periudhat e studimit të përfunduara, me të gjithë dokumentacionin provues dhe dëshmitë mbështetëse të përshkruara në pikën 7 të këtij kreu.

Raporti i hartuar nuk përbën në vetvete një dokument njohjeje dhe njësimi.

9. Në të gjitha rastet, raporti duhet të përmbajë:

a) të dhënat personale të aplikantit (emër, mbiemër dhe atësi - nëse shënohet);

b) emrin, në gjuhën origjinale, të kualifikimit të fituar;

c) emrin, në gjuhën origjinale, të institucionit arsimor ku është fituar kualifikimi, ose janë kryer periudhat e studimit;

d) statusin e institucionit arsimor (licencuar, akredituar/njohur, vlefshmërinë);

e) nivelin e kualifikimit të fituar;

f) të drejtat e fituara nga kualifikimi;

g) vitin në të cilin është fituar kualifikimi, ose është kryer periudha e studimit;

h) dokumentacionin përkatës ku është mbështetur raporti.

9.1 Raporti hartohet dhe lëshohet në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

9.2 Organet kompetente marrin vendimin mbi vijimësinë e arsimimit dhe të punësimit e personave, të cilët kanë statusin e refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatin, bazuar në raportin e hartuar.

10. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët kanë të drejtën e ankimit sipas kreut VI të këtij udhëzimi.

KREU VI

ANKIMI

1. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e dëftesës të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar dhe/ose periudhave të studimit që i përkasin nivelit 1 deri në 4, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të Komisionit të Njohjes së Dëftesave dhe Komisionit të Njohjes së Diplomave, përkatësisht në ZVAP dhe në QSHA, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

2. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e ankuesit.

KREU VII

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Personat të cilët kanë aplikuar dhe/ose kanë paraqitur dokumentacionin për njohjen dhe njësimin e dëftesës të përfundimit të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar dhe/ose periudhave të studimit përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të trajtohen në bazë të dispozitave të udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi deri në funksionimin e plotë të sistemit *online*, aplikimi do të kryhet vetëm në formë shkresore me postë zyrtare.

3. Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin ndiqen përcaktimet e parashikuara në këtë udhëzim, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose më shumë palëshe të nënshkruara ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucionit përgjegjës të autorizuar prej saj dhe një subjekti juridik të huaj, që kanë për objekt njohjen dhe njësimin e diplomave të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit parauniversitar.

4. Udhëzimi nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Njohja dhe njësimi i dëftesave të klasave për arsimin e mesëm të lartë profesional, nuk është objekt i këtij udhëzimi.

6. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe Komisioni i Njohjes së Dëftesave dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi



Shtojca nr.1

FORMULAR APLIKIMI

PËR NJOHJE DHE NJËSIM DIPLOME TË DËFTESA TË ARSIMIT BAZË/DËFTESA
ARSIMIT PARAUNIVERSITARQENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTITNëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
E-mail: knid@zvap.gov.al
Web: www.zvap.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

*Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe
qartë informacionin e kërkuar në fushat
më poshtë.*

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	Data Muaji Viti
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Bashkia	
12. Kod i Postar		13. E-mail	
14. Nr. Tel. Celular		15. Nr. Tel. Fiks	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Njohje Dëftese	☐ Njohje dhe njësime dëftese e arsimit parauniversitar
17. Dëftesa që do njihet	
18. Emri i Institucionit të Arsimit Parauniversitar (IAP)	
19. Pranuar më	Data Muaji Viti
20. Përfunduar më	Data Muaji Viti
21. Kohëzgjatja zyrtare (vite)	

22. Kontaktet zyrtare të IAP-së, ku keni ndjekur shkollën

Adresa			
Qyteti		Shteti	
Kodi Postar		E-mail	
Adresa web		Nr. Tel. Fiks	



KLAUZOLA DEKLARATIVE

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar dhe ose IAP-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se nuk kam aplikuar më parë për njohje dhe njësim të kësaj dëftese pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësiave penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9837 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit. Autorizoj dhe lejoj institucionin që të kërkojë të dhënat e mia arsimore në institucionin e arsimit parauniversitar që ka lëshuar dëftesën për të cilën po aplikoj për njohje dhe njësim.

Nënshkrimi i aplikantit

Data		Muaji		Viti			



Shtojca nr.2

FORMULAR APLIKIMI

PËR NJOHJE DHE NJËSIM DIPLOME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:

E-mail: senjod@qsha.gov.alWeb: www.qsha.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja			Data Muaji Viti
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Bashkia	
12. Kodi Postar		13. E-mail	
14. Nr. Tel. Celular		15. Nr. Tel. Fiks	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Njohje Diplome	☐ Njohje dhe njësim diplome e përfundimit të arsimit parauniversitar
17. Diploma që do njihet	
18. Emri i Institucionit të Arsimit Parauniversitar (IAP)	
19. Pranuar më	
	Data Muaji Viti
20. Diplomuar më	
	Data Muaji Viti
21. Kohëzgjatja zyrtare (vite)	
22. Kontaktet zyrtare të IAP-së, ku jeni diplomuar	

Adresa			
Qyteti		Shteti	
Kodi Postar		E-mail	
Adresa web		Nr. Tel. Fiks	



KLAUZOLA DEKLARATIVE

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe ose IAP-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se nuk kam aplikuar më parë për njohje dhe njësim të kësaj diplome pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin apo Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësi penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit. Autorizoj dhe lejoj institucionin që të kërkojë të dhënat e mia arsimore në institucionin e arsimit parauniversitar që ka lëshuar diplomën për të cilën po aplikoj për njohje dhe njësim.

Nënshkrimi i aplikantit

--	--	--	--	--	--	--	--

Data

Muaji

Viti



Shtojca nr. 3

TABELA E KONVERTIMIT TË NOTAVE TË SHKOLLËS

Shteti	Klasat	Notat						
Shqipëria	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Greqia	1-4	4.00-4.90		5.00-6.49		6.50-7.49	7.50-8.49	8.50-10.00
	5-6	4.00-4.90	5	6	7	8	9	10
	7-12	7-9	10	11-12	13-14	15-16	17-18	19-20
Kosova	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Mali i Zi	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Maqedonia e Veriut	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Serbia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Bosnja dhe Hercegovina	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Çekia	1-12	5	-	4	3	2	-	1
Slovakia	1-12	5	-	4	3	2	-	1
Rusia	1-5	1	-	2	3	-	4	5
Kroacia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Sllovenia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Italia	1-13	5	-	6	7	8	9	10
Turqia	1-12	25-44	45-49	50-54	55-61	62-69	70-84	85-100
Gjermania	1-12	6	5	4	-	3	2	1
Austria	1-13	6	5	4	-	3	2	1
SHBA	1-12	F	-	D	-	C	B	A
Mbretëria e Bashkuar	1-12	F	-	D	-	C	B	A
Irlanda	1-12	7-8	6	5	4	3	2	1
Bullgaria	1-12	2	-	3	-	4	5	6
Polonia	1-12	1	-	2	3	4	5	6
Rumania	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Franca	1-12	9.99	-	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	16.00-20.00
Belgjika	1-12	9.99	-	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Luksemburgu	1-12	1-29	-	30-35	36-39	40-47	48-51	52-60
Zvicra	1-12	2-3	-	4	-	5	-	6
Norvegjia	1-12	1	-	2	3	4	5	6
Holanda	1-12	1-5	-	6	7	8	9	10
Finlanda	1-12	1	2	3	4	5	6	7
Suedia	1-12	F	-	E	D	C	B	A
Spanja	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Danimarka	1-12	1.99	-	2-3.99	4-6.99	-	7-9.99	10-12
Estonia	1-12	0	1	2	3	4	-	5
Hungaria	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Letonia	1-12	1-3	4	5	6	7	8	9-10
Lituania	1-12	1-4	5	6	7	8	9	10
Portugalia	1-12	0-9	-	10	11-13	14-17	-	18-20
Egjipti	1-12	0-49	-	50-64	65-74	-	75-84	85-100



Shtojca nr. 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
KOMISIONI I NJOHJES SË DËFTESAVE

Nr. prot. _____, nr. regjistrimit _____, më _____._____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e dëftesës së arsimit bazë, dëftesës së klasës, së z./znj. _____ (emër atësi, mbiemër), lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar dëftesën), _____ (shteti), më datë _____._____ (data e lëshimit të dëftesës).

Bashkëlidhur këtij vërtetim gjendet tabela e konvertimit të notave

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

DREJTORI KRYETARI I KOMISIONIT

*Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me dëftesën e njohur dhe të njësuar.

Shtojca nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
KOMISIONI I NJOHJES SË DIPLOMAVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës së arsimit parauniversitar, së z./znj. _____ (emër atësi, mbiemër), lëshuar nga _____ (institucioni i arsimit parauniversitar që ka lëshuar diplomën), _____ (shteti), më datë _____._____ (data e lëshimit të diplomës), lloji i arsimit të mesëm të lartë _____, nota mesatare e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, notat e njëvlerëshme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë _____, nota mesatare e provimeve të maturës _____, nota mesatare e përgjithshme e njëvlerësuar, sipas VKM-së për notën mesatare _____.

Bashkëlidhur këtij vërtetimi gjendet tabela e konvertimit të notave.

Kjo diplomë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM KRYETARI I KOMISIONIT

*Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e njohur dhe të njësuar.

**KËRKESË****Nr. 367/11, datë 10.7.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Restaurimi i peizazhit urban të sheshit të ‘Selamllikut’, i lagjes ‘Mangalem’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall+ndërtesë” sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, ndërsa vlerësimi ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës

së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jo banimi”, i ndryshuar. Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9,869,535.59 (nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI
“RESTAURIMI I PEIZAZHIT URBAN TË SHESHIT TË ‘SELAMLLIKUT’, I LAGJES ‘MANGALEM’”

Nr.	STATUSI JURIDIK		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-Berat)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË											Dokumenti i Pronësisë	VLERA TOTALE (lekë)	Shenime
	PRIVAT	Statusi	Zona Kadastrale		Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "are "			Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim ndertese			Vegjetacioni				
	Emri Atësia Mbiemri							Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Lloji dhe sasia	Vlera (lekë)			
0	1	2	3		4	5	6	7	8		10	11	12	13	14	15		16	17		Seksioni D -E i karteles
1	Evdal Murat Dura	Pronar	8502	Vol 15 fq 140	3/252	Truall	400				400.00	5,879.50	2,351,800.00			6,100,000.00			Kartela e Regj & harte treg	8,451,800.00	4.11.2008.Ne favor te Procredit Bank.Vlera 250000 afati 12 muaj 4500000 Afati 60 muaj 10.06.2012.Kufizohet pasuria me urdher nr 15 date 10.06.2013.14.06.2018 ka nje ndertim te paligjshem
2	Afrim Mustafa Azizolli, Artur Mustafa Azizolli	Pronar	8502	Vol 14 fq 91	3/244	Truall	747				241.13	5,879.50	1,417,735.59						Kartela e Regj & harte treg	1,417,735.59	Mbi kete pasuri ka nje ndertim te paligjshem
3	SHTET	SHTET	8502	Vol 17 fq 134	3/487	Truall	1975.6				1,975.60									-	
4	SHTET	SHTET	8502	Vol 31 fq 212	3/485	Truall	56.7				56.70	-							Kartela e Regj & harte treg	-	
	TOTAL												3,769,535.59			6,100,000.00				9,869,535.59	

**KËRKESË****Nr. 373/6, datë 10.7.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për disa shtesa në VKM-në nr. 31, datë 17.1.2018, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Rehabilitimi i lumit Gjanicë, Fier’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë

3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3,737,400 (tre milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR DISA SHITESA NË VKM-në NR. 31, DATË 17.1.2018, “PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘REHABILITIMI I LUMIT GJANICË, FIER’”

Nr.	Pronari							Vlerësimet për shpronësim				Shënime (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
								Truall			Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	D	E	F	G	M	N	O	Y	Z
1	Fatos Sadik Buzi, Mirela Dule Buzi			8531	6/273	Truall	300	300	12458	3737400	3737400	Konfirmuar nga ASHK-ja
				SHUMA PARAPRAKE								

KËRKESË**Nr. 420/7, datë 11.7.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Qendra shëndetësore ‘Drobonik’, Bashkia Berat’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës

së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 24 360 (njëzetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE E PRONARËVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘QENDRA SHËNDETËSORE ‘DROBONIK’, BASHKIA BERAT”

Nr.	Statusi juridik		Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-Berat)					Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë										Vlera totale	Shënime
	Privat	Statusi	Zona kadastrale		Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”			Shpronësim ndërtesë					
	Emri Atësia Mbiemri							Sip.	Çmimi	Vlera	Sip.	Çmimi	Vlera	Sip.	Çmimi	Vlera			
								(m²)	(lek/m²)	(lek)	(m²)	(lek/m²)	(lek)	(m²)	(lek/m²)	(lek)			
0	1	2	3		4	5	6	7	8	9=7*8	10	11	12	13	14	15	16=12+15	Seksioni E i kartelës	
1	AFRIM YZEDIN BRAUSHII	Pronar	1559	Vol. 8, f. 68	53/98	Truall	220				120	203	24360				24360		
	TOTALI																24360		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë